

Ligjet ekzistuese në Kosovë që merren me çështjet e pronës dhe trashëgimisë:

- Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore
- Ligji për noterinë
- Ligji për kadastër
- Ligji mbi themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme
- Ligji për trashëgiminë për Kosovën
- Ligji për procedurën kontestimore
- Ligji për procedurën jokontestimore
- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve

Për më shumë: www.kuvendikosoves.org,
ligjet sipas emrit

Neni 1: "Mbrotjtja e pronës":

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Protokoll shtesë i Konventës së Mbrotjtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore:

Neni 46: Mbrotjtja e Pronës:

E drejta e pronës është e garantuar. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës



Syri i Vizionit

Increasing Citizen's Awareness and Participation in the Justice System

**"MBROJE
PRONËN
TËNDE"**



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



Ky publikim u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja është përgjegjësi e organizatës "Syri i Vizionit" dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

BARTJEN E TRASHËGIMISË NË RASTET KUR NUK KA KONTESTE, E BËN NË PROCEDURË TË SHPEJTË ZYRA E NOTERISË NË KOMUNËN TUAJ.

NË RAST TË KONTESTEVE, PROCEDURAT ZGJIDHEN NGA GJYKATAT.

Neni 29: Funkcionet noteriale janë:

trajtimi i të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore; ofrimi i asistencës juridike; përpilimi dhe vërtetimi i kontratave; nënshkrimi dhe vulosja e aseteve që do të ndahen në kontekst të procedurave trashëgimore dhe të falimentimit; etj.

Ligji për noterinë

Transaksionet ndërmjet të gjallëve: Cedimi dhe ndarja e pasurisë- Nenet 58-61:

Paraardhësi me anë të veprimit juridik për së gjalli mund t'ua cedojë dhe t'ua pjesëtojë pasurinë e vet pasardhësve të tij. Marrëveshja mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë duhet të përpilohet me shkrim dhe të vërtetohet nga gjyqtari.

Ligji për trashëgimi

Neni 18, Pronësia: Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.

Neni 36: Fitimi i pronësisë në

paluajtshmëri: Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri. Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente

Neni 40: Fitimi me parashkrim:

Personi i cili me mirëbesim e ka 20 vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të. Personi i cili e ka 10 vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri dhe nëse ai është regjistruar si posedues pronësor në kadastër e fiton pronësinë në paluajtshmerinë ose në ndonjë pjesë të saj, në qoftë se brenda këtij afati nuk është regjistruar ndonjë kundërshtim lidhur me regjistrimin.

Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat sendore
